



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Adresa: Rr. "Abdi Toptani", ish-hotel "Drini", Tiranë

Tel/Fax 04 2226814; 22268142

Nr. 103/5 Prot.

Tiranë, më 27.04.2017

**V E N D I M**

Nr. 106, datë 27/04/2017

***"Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të vendimit të Komisionerit nr.160, datë 14.12.2016 dhe ligjshmërisë së veprimeve administrative të kryera gjatë procesit të emërimeve nga institucioni i Prefektit të Qarkut Kukës, prej datës 19.09.2016 e në vazhdim"***

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe nenin 34 e vijues të Rregullores, "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit nr. 160, datë 14.12.2016, "Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin e Prefektit të Qarkut Kukës dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë", në institucionin e Prefektit të Qarkut Kukës,

**VËREJ SE:**

Me Vendimin Nr.139, datë 30.12.2015, "Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në procesin e administrimit të shërbimit civil në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe institucionet e varësisë që janë pjesë e shërbimit civil", Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka vendosur fillimin e procesit të mbikëqyrjes së përgjithshme në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe institucionet e varësisë që janë pjesë e shërbimit civil. Bazuar në këtë vendim ka vijuar mbikëqyrja edhe në institucionin e Prefektit të Qarkut Kukës. Ky proces është përmbyllur me Vendimin Nr. 160, datë 14.12.2016, "Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin e Prefektit të Qarkut Kukës dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë", të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në të cilin është vendosur:

1. Të miratoj raportin përfundimtar të mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me administrimin e shërbimit civil në institucionin e Prefektit të Qarkut Kukës, i cili është pjesë e këtij vendimi dhe të paralajmëroj institucionin për të rregulluar situatën e paligjshmërisë në zbatimin e ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, duke kërkuar zbatimin e detyrave që do të specifikohen më poshtë.
2. Për të rregulluar situatën në lidhje me pozicionin e punës "Sekretar i Përgjithshëm", në institucionin e prefektit të qarkut, me qëllim sqarimin e rolit të tij në skemën e administrimit të shërbimit civil, njësia përgjegjëse (DAP), duhet të përcaktojë kategorinë e shërbimit civil në të cilën klasifikohet ky pozicion, ose pozicionin e barasvlershëm me të, sipas kategorive dhe klasave të parashikuara në nenin 19, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar dhe pikën 5, të kreut 2, të vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura", i ndryshuar. Ky proces duhet të gjejë pasqyrim edhe në përshkrimin e punës për pozicionin "Sekretar i Përgjithshëm", në institucionin e prefektit.
3. Të kërkoj nga Sekretari i Përgjithshëm i institucionit dhe Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, si organizma që menaxhojnë burimet njerëzore të institucionit, të përfundojnë hartimin e përshkrimeve të reja të punës për të gjitha pozicionet e shërbimit civil, sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në vendimin nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura", i ndryshuar, lidhjeve pjesë e këtij vendimi dhe në përputhje me orientimet që janë dhënë në rubrikën përkatëse të Raportit Përfundimtar të Mbikëqyrjes.

*Institucioni i mbikëqyrur t'i kërkojë Departamentit të Administratës Publike, që të japë zyrtarisht konfirmimin e tij, lidhur me përshkrimet e punës, nëse ato janë të hartuara në bazë dhe në përputhje me legjislacionin specifik të fushës apo formatin standard të miratuar, siç parashikohet në pikën 19, të vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura", i ndryshuar.*

*Pas marrjes së konfirmimit nga njësia përgjegjëse (DAP), përshkrimet e punës t'i dërgohen Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme, për të vijuar procesin me nënshkrimin e tyre në ndarjen përkatëse, siç parashikohet në pikën 18, shkronja "c", të vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura", i ndryshuar.*

*Një kopje e përshkrimeve të punës të nënshkruara të bëhen pjesë e dosjes së personelit të çdo nëpunësi civil, një kopje të depozitohet në arkivin e institucionit dhe një kopje të depozitohet pranë Departamentit të Administratës Publike.*

4. Njësia përgjegjëse, Departamenti i Administratës Publike, në kuptim të nenit 108 dhe III, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", për punonjësit \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\* , duhet të konstatojë

*pavlefshmërinë e pjesshme absolute të aktit, me të cilin është refuzuar deklarimi i statusit të punësimit për këta punonjës, si një akt i nxjerrë në kundërshtim me ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, pasi pozicionet e gjendjes civile, ku këta punonjës ushtrojnë detyrën e tyre, nuk janë pjesë e shërbimit civil, por janë funksione të deleguara. Marrëdhënia e tyre e punës do të vijojë sipas Kodit të Punës dhe specifikave të ligjit për gjendjen civile.*

*Për ndreqjen e këtyre parregullsive, në zbatim të nenit 113, të Kodit të Procedurave Administrative, Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, duhet të veprojë si më poshtë:*

- *Të anulojë pjesërisht aktin nr. 3298, datë 30.10.2014, “Verifikim i statusit të nëpunësve dhe punonjësve aktual”, në paragrafin 3) dhe 6), ku refuzohet deklarimi i statusit të punësimit për punonjësit \*\*\*\*\*\*, me detyrë “Specialist i gjendjes civile”, në Nënprefekturën e Rrethit Tropojë dhe \*\*\*\*\*\*, me detyrë “Specialist i Zyrës së gjendjes civile Kukës”.*
- 5. *Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore në institucionin e Prefektit të Qarkut Kukës, në kuptim të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe të vendimit 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duhet t’i kërkojë punonjësit \*\*\*\*\*\*, me detyrë “Sekretar i Përgjithshëm”, në institucionin e Prefektit të Qarkut Kukës, të paraqesë diplomën e përfundimit të programit të studimeve “Master i Shkencave” dhe listën e notave, me qëllim që të provojë se i përmbush kushtet për të qenë pjesë e shërbimit civil, pasi afati i përcaktuar në ligj për dorëzimin e tyre ka përfunduar.*

*Një kopje e këtyre dokumenteve, të cilat duhet të jenë origjinale ose fotokopje të vërtetuara nga noteri, duhet t’i dërgohet Departamentit të Administratës Publike dhe një kopje duhet të bëhet pjesë përbërëse e dosjes personale të nëpunësit.*

*Pas marrjes së dokumentacionit të mësipërm, njësia përgjegjëse, Departamenti i Administratës Publike, duhet të vijojë me përfundimin e procedurës së deklarimit të statusit të punësimit për punonjësin \*\*\*\*\*\*.*

- 6. *Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit të mbikëqyrur, në rastin e punonjësës \*\*\*\*\*\*, me detyrë “Specialist i shërbimeve të brendshme”, në Sektorin e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme, duhet t’i komunikojë njësisë përgjegjëse vendimin nr. 580, datë 03.08.2016, të Prefektit, “Konfirmim i statusit të nëpunësit civil në periudhë prove”, me të cilin është vendosur konfirmimi pas përfundimit të periudhës së provës.*

*Pas njoftimit të vendimit të konfirmimit për periudhën e provës, njësia përgjegjëse (DAP), në zbatim të Kreut VI, pika 13, të vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, duhet të nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të nëpunësit, për punonjësen \*\*\*\*\*\*.*

7. *Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit të Prefektit të Qarkut Kukës dhe personat përgjegjës, të ngarkuar nga ligji me detyrën e vlerësimit të rezultateve në punë, duhet të mbajnë parasysht rekomandimet e Komisionerit, të cilat janë të materializuara në raportin e mbikëqyrjes, më qëllim kryerjen e vlerësimit të rezultateve në punë në mënyrë sa më objektive, duke e lidhur atë me realizimin e detyrave konkrete të secilit nëpunës.*
8. *Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit të Prefektit të Qarkut Kukës, në respektim të nenit 62, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar dhe Vendimit nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë", i ndryshuar, të kryejë procedurën e vlerësimit të rezultateve në punë për periudhën Janar - Qershor 2015, për punonjësit e mëposhtëm:*
  - ✓ *\*\*\*\*\*, e cila në momentin e kryerjes së vlerësimit ka qenë e emëruar në pozicionin "Specialist në Sektorin e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme";*
  - ✓ *\*\*\*\*\*, e cila në momentin e kryerjes së vlerësimit ka qenë e emëruar në pozicionin "Specialist në Sektorin e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme".*

*Në përfundim të procesit, formulari i vlerësimit për nëpunësit e mësipërm, të përfshihet në Regjistrin Qendror të Personelit, siç parashikohet në pikën 18, të Kreut II, të aktit nënligjor si më sipër.*

9. *Njësia përgjegjëse dhe njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit të mbikëqyrur, në zbatim të Kreut II, pika 20, të vendimit nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë", për nëpunësit civilë, pozicionet e të cilëve pësuan ndryshim, për shkak të ristrukturimit të institucionit të Prefektit të Qarkut Kukës, duhet të drejtojnë procesin e plotësimit të dosjeve të personelit me mendimin me shkrim për pranimin e transferimit të përhershëm në kuadër të ristrukturimit.*
10. *Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit të sistemojë dosjen e personelit të çdo nëpunësi civil, duke përfshirë në të, të gjitha dokumentet dhe të dhënat sipas lidhjeve 1 e 2, pjesë e vendimit nr. 117, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit", si dhe ato që janë deklaruar me mangësi në anekset përkatëse, të cilat janë pjesë e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.*
11. *Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat 30 ditë nga marrja dijeni për këtë vendim. Institucioni i mbikëqyrur dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim duke u bazuar në orientimet e dhëna në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.*

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim verifikimin e zbatimit të detyrave të lëna në Vendimin paralajmërues nr. 160, datë 14.12.2016, të Komisionerit, si dhe verifikimin e ligjshmërisë së veprimeve administrative të kryera gjatë realizimit të procedurave për rekrutim, transferim, ngritje në detyrë, në institucionin e Prefektit të Qarkut Kukës, prej datës 19.09.2016 që është momenti i verifikimit të kryer në kuadër të mbikëqyrjes e në vazhdim, me Vendimin nr.

25, datë 10.02.2017, *“Për verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit nr. 160, datë 14.12.2016 dhe ligjshmërinë e veprimeve administrative të kryera nga institucioni i Prefektit të Qarkut Kukës, gjatë procesit të emërimeve, të kryera prej datës 19.09.2016 e në vazhdim”*, ka vendosur fillimin e verifikimit të zbatimit të Vendimit nr. 160 datë 14.12.2016, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në Institucionin e Prefektit të Qarkut Kukës dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”*.

Verifikimi u realizua nëpërmjet vizitës në institucionin e Prefektit të Qarkut Kukës, dhe subjekti u njoftua për fillimin e procesit me shkresën nr. 103/2 prot., datë 10.02.2017 *“Njoftim për fillimin e verifikimit”*.

Bazuar në procesverbalin e datës 23.03.2017, të mbajtur nga grupi i punës i Komisionerit dhe nënshkruar edhe nga personat e kontaktit të institucionit të Prefektit të Qarkut Kukës dhe pas shqyrtimit të materialeve shkresore të administruara në përfundim të procesit të verifikimit, rezultoi sa më poshtë vijon:

- Me shkresën nr.160, datë 21.03.2017, Prefekti i Qarkut Kukës, në zbatim të pikës 2 të rekomandimit të vendimit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil i ka kërkuar Departamentit të Administratës Publike interpretim në lidhje me kategorinë dhe klasifikimin e pozicionit të Sekretarit të Përgjithshëm në skemën e administrimit të shërbimit civil.

Departamenti i Administratës Publike nuk është shprehur ende në lidhje me kategorinë e shërbimit civil në të cilën klasifikohet pozicioni *“Sekretar i Përgjithshëm”*, në institucionin e prefektit të qarkut ose pozicionin e barasvlershëm me të, sipas kategorive dhe klasave të parashikuara në nenin 19, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe pikën 5, të kreut 2, të vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*, i ndryshuar, sikundër ishte lënë detyrë në pikën 2 të dispozitivit të vendimit paralajmërues të Komisionerit.

- Në zbatim të pikës 3 të vendimit, Njësia e Burimeve Njerëzore të institucionit ka hartuar përshkrimet e punës për të gjitha pozicionet e shërbimit civil. Me shkresën nr. 154 prot., datë 13.03.2017, *“Për konfirmim të përshkrimeve të punës”*, i është kërkuar Departamentit të Administratës Publike që të konfirmojë nëse përshkrimet e punës janë hartuar në bazë dhe në përputhje me legjislacionin specifik të fushës apo formatin standard të miratuar, siç përcaktohet në pikën 19, të Vendimit Nr.142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*. Në momentin e verifikimit, nga ana e Departamentit të Administratës Publike nuk është kthyer përgjigje në lidhje me shkresën e sipërcituar.
- Në pikën 4 të vendimit paralajmërues të Komisionerit, i është kërkuar njësisë përgjegjëse, Departamentit të Administratës Publike, që në kuptim të nenit 108 dhe 111, të ligjit nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, të konstatojë pavarshmërinë absolute të akteve të nxjerra në kuadër të procedurës së deklarimit të

statusit të punësimit, për punonjësit \*\*\*\*\*, dhe \*\*\*\*\*, si akte të nxjerra në kundërshtim me ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, pasi pozicionet e punës në zyrën e gjendjes civile, ku këta punonjës ushtrojnë detyrën e tyre, nuk janë pjesë e shërbimit civil, por janë funksione të deleguara.

Ashtu sikundër është pasqyruar edhe në procesverbalin e mbajtur në subjekt gjatë procesit të verifikimit, rezulton se Departamenti i Administratës Publike nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për zbatimin e kësaj pike të vendimit të Komisionerit.

- Në zbatim të rekomandimit të pikës 5 të vendimit të Komisionerit, me shkresën nr.160, datë 21.03.2017, i është kërkuar nëpunësit \*\*\*\*\* diploma e përfundimit të programit të studimeve “*Master i Shkencave*” dhe lista e notave, me qëllim që të provojë se i përmbush kushtet për të qenë pjesë e shërbimit civil në pozicionin “*Sekretar i Përgjithshëm*”, pasi afati për dorëzimin e dokumentave ka përfunduar. Deri në momentin e verifikimit të zbatimit të vendimit dokumentacioni i mësipërm nuk është paraqitur nga nëpunësi \*\*\*\*\* dhe për këtë arsye me shkresën e mësipërme ky fakt i është bërë me dije Departamentit të Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse për vijimin e përfundimit të procedurës së deklarimit apo jo të statusit të punësimit për punonjësin \*\*\*\*\*.
- Njësia e burimeve njerëzore të Prefektit Kukës, në zbatim të pikës 6 të vendimit me shkresën nr. 718 prot., datë 27.10.2016 i ka komunikuar njësisë përgjegjëse (DAP), vendimin nr.580, datë 03.08.2016, për konfirmimin e statusit të punësimit të punonjëses \*\*\*\*\* në detyrën “*Specialiste në sektorin e financës dhe shërbimeve mbështetëse*”.

Departamenti i Administratës Publike, pas marrjes së njoftimit të mësipërm, në zbatim të Kreut VI, pika 13, të vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”, ka nxjerrë aktin Nr. 6631/3 Prot., datë 30.12.2016, për deklarimin e statusit të punësimit “*Nëpunës civil*” për punonjësen \*\*\*\*\* në pozicionin “*Specialiste në sektorin e financës dhe shërbimeve mbështetëse*”.

- Në zbatim të rekomandimit të pikës 7 të vendimit paralajmërues të Komisionerit, njësia e burimeve njerëzore dhe personat përgjegjës të ngarkuar nga ligji me detyrën e vlerësimit të rezultateve në punë, në përputhje me rekomandimin e Komisionerit kanë bërë vlerësimin e rezultateve në punë për periudhën Korrik-Dhjetor 2016.
- Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit të Prefektit të Qarkut Kukës, në zbatim të pikës 8 dhe në respektim të nenit 62, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe Vendimit nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë*”, i ndryshuar, ka bërë vlerësimin e rezultateve në punë për periudhën Janar - Qershor 2015, për punonjësit e mëposhtëm:
  - ✓ \*\*\*\*\*, e cila në momentin e kryerjes së vlerësimit ka qenë e emëruar në pozicionin “*Specialist në Sektorin e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme*”;
  - ✓ \*\*\*\*\*, e cila në momentin e kryerjes së vlerësimit ka qenë e emëruar në pozicionin “*Specialist në Sektorin e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme*”.

Në përfundim të procesit, formulari i vlerësimit për nëpunësit e mësipërm, është përfshirë në Regjistrin Qendror të Personelit, siç parashikohet në pikën 18, të Kreut II, të aktit nënligjor si më sipër.

- Në lidhje me zbatimin e rekomandimit të pikës 9 të vendimit paralajmërues të Komisionerit për plotësimin e dosjeve të personelit me mendimin me shkrim për pranimin e transferimit të punonjësve për shkak të ristrukturimit të institucionit, njësia përgjegjëse nuk kishte reaguuar, por faktikisht të gjithë nëpunësit e transferuar vazhdonin normalisht punën, gjë që presupozon pranimin e pozicionit aktual të punës. Duke qenë se kjo është një kërkesë formale që nuk cenon thelbin e procesit, njësia përgjegjëse dhe njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit, duhet të bëjnë kujdes që kjo situatë të mos përsëritet në të ardhmen.
- Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore në zbatim të pikës 10 ka sistemuar dosjen e personelit të çdo nëpunësi civil, duke përfshirë në të, të gjitha dokumentet dhe të dhënat sipas lidhjeve 1 e 2, pjesë e vendimit nr. 117, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”*, si dhe ato që ishin deklaruar me mangësi në anekset përkatëse, të cilat janë pjesë e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.

Për sa u parashtrua më sipër, pas përfundimit të afatit për zbatimin e detyrave të lëna në Vendimin nr. 160 datë 14.12.2016, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në Institucionin e Prefektit të Qarkut Kukës dhe paralajmërimit të institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”*, të Komisionerit, rezultoi se nga ana e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit të Prefektit janë zbatuar të gjitha rekomandimet e lëna në vendimin paralajmërues.

Në përfundim të procesit të verifikimit në subjekt, lidhur me ligjshmërinë e veprimeve administrative të kryera gjatë realizimit të procedurave për rekrutim, transferim, ngritje në detyrë, në institucionin e Prefektit të Qarkut Kukës, prej datës 19.09.2016 që është momenti i verifikimit të kryer në kuadër të mbikëqyrjes e në vazhdim, rezultoi se aktet e emërimeve në pozicionet e shërbimit civil janë nxjerrë nga njësia përgjegjëse, DAP, sipas parashikimeve të pikës 19, të kreut IV dhe pikës 22 të kreut VII, të Vendimit Nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, *“Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”*.

#### **Për këto arsye:**

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; nenin 90, të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* dhe 34 të Rregullores, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

#### **VENDOSA:**

1. Përfundimin e procesit të verifikimit për zbatimin e Vendimit nr. 160, datë 14.12.2016 në institucionin e Prefekturës të Qarkut Kukës.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit të Prefektit, duke zbatuar plotësisht rekomandimet e Vendimit nr. 160, datë 14.12.2016, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në Institucionin e Prefektit të Qarkut Kukës dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”*.
3. Verifikimin e mëtejshëm të pikave 2, 3, 4 dhe 5 të dispozitivit të Vendimit nr. 160, datë 14.12.2016, për të cilat kërkohet reagimi i Njësisë Përgjegjëse, Departamentit të Administratës Publike.
4. Konstatimin e ligjshmërisë së veprimeve administrative, të kryera gjatë procesit të emërimeve nga institucioni i Prefektit të Qarkut Kukës, prej datës 19.09.2016 e në vazhdim.
5. Për këtë vendim të njoftohet institucioni i Prefektit të Qarkut Kukës, Departamenti i Administratës Publike, Ministria e Punëve të Brendshme, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera STRAKOSHA**